



qendra e provimeve

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI PROFESIONAL

QERSHOR 2019

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 150 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.
Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërin prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja.

Me fat!



* A 9 5 9 6 2 *

FAQE E ZBRAZËT

Metodologjia:

Metodat që do të përdoren nga nxënësit për nxjerrjen e një përfundimi dhe produkti të suksesshëm



Figura 1. Metodologjia e përdorur në projektin “Gjuha amtare, simbol i një kombi”

1. Në cilin vit shkollor është zhvilluar ky projekt?

1 pikë

2. Projekti në fjalë është projekt lëndor i:

1. Klasës IV A
2. Klasës IV B
3. Klasës IV C

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

3. Cilat metoda veçohen si më cilësoret që do të përdoren nga nxënësit?

1 pikë

4. Me cilën gjuhë kanë të bëjnë metodat që do të përdoren për nxjerrjen e një përfundimi dhe produkti të suksesshëm?

1 pikë

5. Nëse konstatimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë rretho P dhe argumentoje përgjigjen.

KONSTATATIMI	SAKTË PASAKTË	ARGUMENTIMI I PËRGJIGJES
Është shumë i rëndësishëm leximi i një libri për fëmijë nga një autor shqiptar.	S P	

1 pikë

Spektakli për heronjtë e Kërlezhës të ditëve tona

12/08/2017 08:06

Burimi: Gazeta Pobjeda

Qyteti Teatër i Budvës i ka mundësuar publikut të tij që në Galerinë e mrekullueshme të Artit të Dubrovnikut të shohë shfaqjen e prodhimit të ri të Lojërave Verore të Dubrovnikut, dramën e kultit të Miroslav Kërlezhës „Glembajët“, në adaptim dhe regji të Zllatko Svibenit.

Autobusët të cilët kanë transportuar publikun e Budvës, policia kufitare e Kroacisë i ka lëshuar të kalojnë para një kolone të pakufi të automobilave, kurse një Debeli Brijeg i kanë pritur përfaqësuesit e festivalit të Dubrovnikut.

„Glembajevët“ në leximin e ri të Zllatko Svibenit janë luajtur pesë herë në Lojërat Verore të Dubrovnikut, kurse parmbremë ka përfunduar shfaqja e sivjetshme e tyre në Dubrovnik. Tregimi i Kërlezhës për Glembajët, njerëzit të cilët në seriozitetin e skizofrenisë janë lëvizur nga realiteti, të syrgjynosurit e vetëdijes personale dhe ndërgjegjes, vrasësit, mashtruesit, hajnave dhe manipuluesve, fillon në Atriumin e Galerisë së Arteve. Nga Atriumi, ku njihet me heronjtë e Kërlezhës, publiku ngadalë lëviz nëpër shkallë, ku e pret kori i „shpirtrave të vdekur“, i cili këndon vargjet „Vdekja, është gota e ëndrrës, vdekja, është shije e hidhur e lulëkuqes“ (këngët të cilat dëgjohen gjatë gjithë shfaqjes e aktualizojnë shtesë adaptimin e Svibenit), kurse ky spektakël teatral i llojit të vet vazhdon në skenografinë fantastike në tarracën e Galerisë së Arteve, ku në murin prej gurit janë vendosur edhe portretet e Glembajëve. Në dramën që zgjatë gati katër orë në tri akte, „lajt motivi“ i Glembajëve të Svibenit megjithatë nuk është sfera sociale, sepse ai njëlloj i fokuson edhe fenomenet për femrën, vdekjen, me të cilat Kërlezhës është marrë në veprën e vet.

Kuptimi i ri

Për Mijo Jurishiqin, aktorin e TPK të Splitit, roli i Leone Glembajit është premiera e parë dramatike në Lojërat Verore të Dubrovnikut, kurse në premierë ka marrë duartrokitjet më të mëdha të publikut.

„Jam takuar me Kërlezhën vetëm në provimin pranues në Akademi, gjë që ka qenë larg nën kuptimin tim të rolit dhe veprës së atij njeriut. Për kuptimin e Kërlezhës vetëm tani kam arritur në një moshë kur mundem më mirë ta kuptoj çfarë shkruan ai njeri dhe për çfarë fle. Është fakt se Leonen e kanë luajtur shumë aktor të cilët kanë lënë një gjurmë të madhe në kulturë të kësaj hapësire, dhe për t'u futur në ato këpucë nuk ka qenë lehtë. Në fillim kam qenë shumë i frikësuar – Leonen, të cilin e quajnë edhe Hamleti kroat, ka aq pjesë, sa që për secilën që të përcaktoheni, nuk mund të dështoni. Mund ta luani agresivisht, i tërhequr, në mënyrë intelektuale, superiore, shpejt, ngadalë.... Posaçërisht në vjen mirë që babain tim Ignjat

Glembajin e luan Predrag Ejduš, dhe që kam mundur të qëndroj në skenë së bashku me të”, tha Jurishiq, duke theksuar se është shumë i gëzuar për ardhjen e publikut nga Budva në Dubrovnik.

Shembull i bashkëpunimit kulturor

Për Zllatko Svibenin, sikurse ka deklaruar pas zhvillimit të shfaqjes, ardhja e publikut të Qytetit Teatër i cili e ka mbushur më shumë se gjysmën e vendeve të shikuesve, paraqet dëshminë më të mirë se bashkëpunimi kulturor në këto hapësira dhe bashkëpunimi i dy festivaleve verore të përafërta duhet të vazhdojë.

“Më vjen shumë mirë që shikuesit nga Budva e panë premierën e „Glembajëve“. Ne kemi planifikuar që të jemi mysafir në Qytetin Teatër në kuadër të Programit Dramatik, mirëpo për shkak të skenës e cila teknikisht është shumë kërkuese dhe se nuk do të mund t’i përshtatej aq shpejt Budvës, kemi ardhur në një përfundim të përbashkët që është shumë më lehtë që publiku të vij në Dubrovnik. Gëzohem që marrëveshja jonë është realizuar me një kënaqësi reciproke, posaçërisht jam i gëzuar për mënyrën se si kanë reaguuar shikuesit nga Budva. Është e qartë se ky është publiku të cilin Qyteti Teatër e ka shkolluar gjatë decenieve të kohëzgjatjes së tij, sepse „Glembajevët“ nuk janë lekturë e lehtë dhe shfaqje e lehtë”, tha Sviben.

(<https://www.cdm.me/kultura/spektakli-për-heronjtë-e-ditëve-tona-të-kërlezhës/>)

6. Nëse thënia është e saktë rretho PO, ndërsa nëse është e pasaktë rretho JO.

Shfaqja dramatike <i>Glembajët</i> është luajtur në Galerinë e Arteve të Dubrovnikut.	PO	JO
Teksti është botuar në orën 20 e 6 minuta.	PO	JO
Tre akte të shfaqjes <i>Glembajevët</i> janë luajtur gati katër orë.	PO	JO

1 pikë

7. Kush e ka vendosur në skenë shfaqjen?

1. Miroslav Kërlezha
2. Zllatko Sviben
3. Mijo Jurishiq

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

8. Shpjego për ç'arsye organizatori ka vendosur që shfaqja të zhvillohet në Dubrovnik, dhe jo në Budva.

1 pikë

9. Me cilin stil funksional është shkruar teksti Spektakli për heronjtë e Kërlezhës të ditëve tona?

1. administrativ
2. letraro-artistik
3. gazetaro-publicistik

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

10. Shpjego çfarë ka dashur të theksoi Mijo Jurishiq duke thënë që të futesh në ato këpucë nuk ka qenë lehtë.

1 pikë

11. A) Rretho numrin para personazhit i cili nuk i përket grupit.

1. Akili
2. Andromaka
3. Ismena
4. Hektori

1 pikë

B) Argumento përgjigjen.

1 pikë

12. A) Pranë titullit të veprës shkruaje emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

1. *Albatrosi* _____
2. *Rrungaja në mars* _____
3. *Xha Gorio* _____
4. *Kurora e maleve* _____

1 pikë

B) Cila vepër nga detyra A i përket realizmit?

1 pikë

13. Pranë sjelljeve të personazheve dhe citimeve nga veprat shkruaj kush janë personazhet për të cilët flitet.

SJELLJET E PERSONAZHEVE	CITIMET NGA VEPRAT	PERSONAZHET
Mos u shqetëso, baba, dhe mos akuzo njeri. Kam marrë lajme të mira për paratë e tua dhe erdha këtu të të them se, po të mbushet mendja të më lësh të martohem me Marianën, paratë do të të kthehen.	Që të më vijë mendja duhet të shoh më parë arkën time.	Kush ka marrë lajmet e mira? Kush duhet të shohë më parë arkën?
Motro, mban mend çfarë je nisur të thuash dhe ndjemë se dua të pres fjalën, dua të të rrëfej një të pësuar me këtë Eremitin, tani jam e madhe	Pash zotin, moj ndrikull! Si s'e dallokam unë zërin tënd? Nuk të kujtohet ty, kur në qershor mblidhje gjethe në Gracian e kur nga maja e manit këndoje dhe i bëje të kumbonin të gjitha ato lugina?	Cila do 'ia pres fjalën? Kush se dallon zërin e saj?
Dhe kur anija e vogël me avull mblodhi hekurin dhe e bëri për zallet e Shqipërisë, ndien në zemër një shtrëngim si të një njeriu që mbyll një pjesë të librit të jetës së tij	Oh s'është gjë, një morr vetëm-..., e vuri mi një thua dhe e shtypi me thoin tjetër, pastaj i fshiu duart mbi	Kush ndien në zemër një shtrëngim?

dhe hap një pjesë të re, ku s'di se ç'ka për të shkruar dora e fshehtë e Fatit.	pantallonat.	Kush e shtypi me thoin tjetër?
---	--------------	--

3 pikë

Në bazë të fragmentit të dhënë, si dhe veprës në tërësi, zhvillo detyrat 14 dhe 15.

- Mua për vete, tha Sançoja, - më duket se kalorësit që bëjnë gjithë këto gjëra ishin të detyruar... po... ti përse duhet të luash mendsh? Cila zonë të ka refuzuar ty?
- Po pikërisht këtu është lezeti, - iu përgjigj Don Kishoti. – Ja se sa mahnitshëm e kam shoshitur këtë punë në kokën time – pasi vetëm një kalorës trushkullur mund të inatoset me të drejtë... E ç'vlerë ka atëherë ky zemërim? Ideja ime është të lajthis pa pasur asnjë shkak fare...

14. A) Shkruaje emrin dhe mbiemrin e autorit të veprës nga e cila është shkëputur kjo pjesë.

1 pikë

B) Për çfarë bëhet fjalë në këtë fragment?

1 pikë

15. Cili është karakteri i Don Kishotit në këtë vepër dhe cila është prirja e personazhit kryesor në këtë pjesë të shkëputur?

2 pikë

- 16.** Pranë emrit të personazhit letrar shkruaje titullin e veprës letrare në të cilën paraqitet dhe gjininë letrare të cilës i përket vepra.

(vepra)

(gjinia letrare)

Hilush Vilza _____

Afërdita _____

2 pikë

- 17.** Shkruaje titullin e veprës të cilën poeti i dhënë e ka shkruar në lavdi të dashurisë së tij.

POETI	VEPRA	DASHURIA E POETIT
Françesko Petrarca		Laura
Jeronim De Rada		Rina

1 pikë

- 18.** *I dukej sikur malet do të zgjatnin dorën për ta kthyer përsëri aty... (Gjenerali i ushtrisë së vdekur, I. Kadare)*

Folja e nënvizuar është:

1. në kohën e ardhme, mënyra dëftore
2. në kohën e ardhme të përparme, mënyra dëftore
3. në kohën e tashme, mënyra kushtore
4. në kohën e ardhme të së shkuarës, mënyra dëftore

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

- 19.** hindi, polake, çeke, sllovake, suedeze, norvegjeze, bengale

Në tabelë shëno emërtimin e gjuhës e cila i përket grupit të dhënë të gjuhëve.

GJERMANIKE VERILINDORE	SANSKRITISHTE	SLLAVE PERËNDIMORE

1 pikë

Lexo një pjesë të poezisë pastaj përgjigju në detyrat 20, 21 dhe 22.

O lamtumirë! Atdheu im
po zhduket dalëngadalë:
Gjëmon stuhia me tërbim,
çaçri gërhet mbi valë;
Pas diellit që po flakëron,
po nisemi të lirë;
dhe ty, si atij që perëndon
Atdhe, natën e mirë!

Kur nesër rishtaz ai diell
do lindë, me shkëlqim,
do përshendesim det e qiell
po jo atdhenë tim.
Në vatrën time nuk ka zjarr
nëpër avllit' e forta
të kullës sime rritet bar,
im qen po leh te porta.

20. Shkruaje titullin e poezisë dhe emrin e mbiemrin e autorit të saj.

1 pikë

21. Duke pasur parasysh vjershën në tërësi, identifikoj motivin e largimit të heroit nga atdheu.

1 pikë

22. A) Çfarë lloj përmbysjeje kemi në vargun *Im qen po leh te porta?*

1 pikë

B) Cila figurë stilistike përfitohet me këtë lloj përmbysjeje dhe si quhet ajo ndryshe?

1 pikë

23. Fjalën e mëposhtme shkruajeni në variantin letrar.

të blerueme

1 pikë

Lexo fragmentin nga vepra *Ura mbi Drinë* (e I. Andriqit) dhe zhvillo detyrat 24, 25 dhe 26.

Në ato mendime, me ngadalësi lëviz Alihoq nga ura. Dhe nuk e vëren se po e përcjellë ai ushtar sanitar. Nuk i dhembte aq veshi sa ajo gjyle prej plumbi dhe e hidhur e cila aty për aty, pas leximit të “fjalëve perandorake” i ra mbi gjoks. Lëviz ngadalshëm dhe i duket se askurrë më nuk do të kalojë në bregun tjetër, se kjo urë, e cila është krenari e qytetit të vogël dhe nga ndërtimi i saj është në një lidhje të ngushtë me familjen e tij, në të cilën është rritur dhe pranë të cilës e kalon shekullin, sakaq u rrënuar në mes, atje te porta; se ajo letër e bardhë dhe e gjerë e proklamatorit gjermane e ka prerë mu në mes si një shpërthim i shurdhër dhe aty rri hapur humnera; që ende qëndrojnë disa shtylla, majtas dhe djathtas nga ajo prerje, por që nuk mund të kalohet, sepse ura nuk lidhet më dy brigjet, dhe secili përgjithmonë do të qëndrojë në atë anë në të cilën atë moment është ndodhur.

24. Në cilin pushtet mendohet kur thuhet “fjalëve perandorake”.

1 pikë

25. Për cilën arsye Alihoxha e përjeton thellë dhe tragjikisht ndryshimin e shkaktuar nga proklamata?

2 pikë

26. Cili është kronotopi (lidhshmëria e kohës-hapësirës të një teksti të rrëfyer) kryesor në romanin *Ura mbi Drinë*? Shpjegoje.

2 pikë

27. Përse romanin *Ura mbi Drinë* cilësohet si roman kronikë?

2 pikë

28. Lexo fjalinë pastaj zhvillo detyrën.

Kritikët heqin të zitë e ullirit kur analizojnë kuptimin e disa paragrafëve.

A) Kuptimi i frazeologjizmit të nënvizuar është:

1 pikë

B) Përcakto funksionin e fjalëve të nënvizuara

1 pikë

29. A) Rrethoje numrin para fjalës e cila është shkruar gabim dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. gjithçka
2. gjysmë
3. prapëseprapë
4. e ndritëshme

1 pikë

B) Në ndërtimin: *Ju ika, ju ika*, fjala *ju* është:

1 pikë

30. Duke shfrytëzuar vetëm të dhënat e nevojshme të cekura në tekst dhe në ilustrimin e mëposhtëm shkruaje një njoftim për përrurimin e librit si një ngjarje e cila duhet të mbahet. Kij kujdes për formën e njoftimit. Respekto normën drejtshkrimore dhe gramatikore.

Përrurimi i librit të Paolo Muner tregoi se autori prezantoi fakte të panjohura për flamujt shqiptarë në anijet tregtare në Shkodër, në vitet 1913-1914. Studimi i tij dygjuhësh, "Një histori Shkodrane", i plotësuar me foto dhe skica të kohës, dëshmon për "një zbulim të vogël historik". Cili ishte flamuri i parë i Shqipërisë së pavarur që u valëvit në Adriatik?

- Një histori shkodrane" quhet hulumtimi i gjatë i Paolo Muner, që udhëton nëpër histori shqiptare me flamurë të panjohur në ato vite të tranzicionit 1913-1914 kur shteti shqiptar ishte ende një shprehje gjeografike e paformësuar, shpërndarë sa nëpër ambiciet e zotëve të vegjël lokalë, aq midis orekseve të perandorive të mëdha që po jepnin shpirt.

Triestini 64 vjeçar, ish ushtarak i marinës së Triestes, ka vendosur të tregojë ato vite duke vrojtuar flamurët e anijeve shqiptare që në atë gjendje amullie ishin simbole të lëkundshme pasqyruese të problemeve të brendshme e të jashtme të Shqipërisë së sapolindur, e madje të palindur ende mirë.

Por Muner, nuk bën vetëm një shëtitje porteve ish austro-hungareze për të hulumtuar flamurë e kuverta anijesh, por ringjall faqeve të librit një Shkodër të së kaluarës që e tillë ka mbetur vetëm në kujtimet dhe identitetin urban të shkodranëve të vjetër. Është Shkodra kozmopolite, ku kulturat përziheshin, e komunikonin me anën tjetër të Adriatikut, ndërsa derdhja e Bunës, e bënte qytetin portual, duke e shndërruar në nyje të gjeopolitikës detare austro-hungareze së bashku me Triesten, Venecian, Budvën e Tivarin. Hulumtimi

shumë-vjeçar i Muner-it, hedh dritë për atë periudhë para se secili nga këto porte të shndërrohej në periferi turistike të shteteve të reja adriatike.

Moderatore e mbrëmjes ishte Leonora Buçinca.

The poster features a background image of a harbor with several sailboats. On the left, there is a vertical text 'PAOLO MUNER' and 'NJE HISTORI SHKODRANE'. The central text reads: 'PAOLO MUNER' above a flag, 'NJE HISTORI SHKODRANE', 'FLAMURIT E PARË TË ANIJEVE TREGTARE SHQIPTARE (1913-1914)', and 'shqipëruar nga Albana Nexhipi' with a red circular logo. On the right, it says 'SHOQATA KULTURORE "ILIRIA" NE KOPER/CAPODISTRIA (SLO) ORGANIZON:', 'Koper / Capodistria, 22 Janar 2017 ora 15:00', 'Istrska Cesta, 41 -6000', 'PROMOVIMIN I LIBRIT: "NJE HISTORI SHKODRANE"', 'TE HISTORIANIT E ALBANOLOGUT TRIESTIN, PAOLO MUNER', and 'PREZANTON: LEONORA BUÇINCA'. A small portrait of Paolo Muner is in the bottom right corner.

(Përgatitur sipas tekstit të Marjola Rukaj, Bota shqiptare 213)

10 pikë



2.

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.